



Spektri i autizmit

hilft,
vermittelt und
verbindet

autismus

deutsche schweiz

Verein für Angehörige, Betroffene und Fachleute

Spektri i çrregullimeve të autizmit

Spektri i çrregullimeve të autizmit (gjermanisht: Autismus-Spektrum-Störungen, ASS) dhe simptomat e tij karakteristike

■ Faqe 6

Ana tjetër e autizmit

■ Faqe 11

T'i dallojmë çrregullimet e spektrit të autizmit

Diagnoza

■ Faqe 14

Spektri i çrregullimeve të autizmit shfaqet në forma të ndryshme

■ Faqe 16

Si të sillemi me personat me spektër të autizmit?

Ndihma e mundshme dhe parimet e trajtimit

■ Faqe 20

Çka mund të bëjnë familjarët dhe të tjerët përreth?

■ Faqe 22

Si person i prekur nga autizmi kam nevojë...

■ Faqe 24



«Autizmi është bekim DHE mallkim.
Unë vërej gjëra të mrekullueshme, si për
shembull buburrecin që zvarritet në bar,
mirëpo nuk e vërej që livadhi, ku rritet
bari, është një fushë futbollli.»

Andreas, një i ri me autizëm





Spektri i çrregullimeve të autizmit

Spektri i çrregullimeve të autizmit dhe simptomat e tij karakteristike

Fjala «autizëm» vjen nga greqishtja e vjetër dhe ka domethënien «të jesh shumë i përqendruar në vetveten». Studiuesit Hans Kanner-i dhe Georg Asperger-i e kanë përdorur këtë term për herë të parë në vitet 1943, përkatësisht 1944, për fëmijët me probleme të rënda lidhur me zhvillimin e tyre. Fëmijët, të rinjtë/të rejtat dhe të rriturit me autizëm mund të tregojnë shumë veçanti në jetën e përditshme. Ndër to mund të dallohen trajta të përbashkëta, mirëpo edhe dallime të mëdha individuale. Pikërisht kjo larmi është arsyeja që të flitet për spektrin e autizmit.



«Disa zhurma më krijojnë dhimbje të mëdha në veshët e mi, njëjtë si freza e dentistit kur ajo prek një nerv.»

Temple Grandin

A është autizmi një sëmundje, një çrregullim, një e metë ose një variant për sa i përket perceptimit, ndjeshmërisë dhe të menduarit njerëzor?

Ekzistojnë veçanti neurologjike për të cilat ekspertët dhe ekspertet mund ta dallojnë nevojën e trajtimit ose të përkrahjes dhe mundësitë për të arritur më shumë me terapi dhe trajnime sociale. Personat autist, të cilët vetë janë të prekur me autizëm, janë kundër një vlerësimi negativ të autizmit. Simptomat dhe pasojat e tyre për jetën e përditshme luajnë një rol të rëndësishëm për vlerësimin e autizmit. Në broshurën tonë nisemi nga hipoteza që shumica e fëmijëve dhe të rinjve/të rejave me autizëm tregojnë ngecje/vonesa të konsiderueshme në zhvillimin dhe kanë vështirësi të mëdha në jetën e tyre të përditshme. Sistemi i klasifikimit 'ICD 11' e

*Shumica e thënieve të kësaj broshure vlejnë njëlloj si për fëmijët, të rinjtë/të rejtat, ashtu edhe për të rriturit. Për ta lehtësuar leximin, nuk do të përmenden çdo herë të gjitha grupet. Të gjitha përmendjet e personave vlejnë njëlloj për të gjitha gjinitë (m/f/divers).

përdor termin «Spektri i çrregullimeve të autizmit» (gjermanisht «Autismus-Spektrum-Störung», shkurt ASS) dhe i vë në pah simptomat dhe dobësitë. Megjithatë duke i përfillur dhe çmuar anët e forta të të prekurve me autizëm jemi të bindur që njerëzit me autizëm japin kontribute të rëndësishme në të gjitha fushat shoqërore.

Si dallohen njerëzit me autizëm nga njerëzit «neurotipikë» pa autizëm?

Autistische Auffälligkeiten können in zwei Hauptgruppen eingeteilt werden:

- **Simptoma sociale** – p.sh. motivacion social i dobët, komunikim gojor ose nonverbal i kufizuar, probleme të empatisë, vështirësi me rregullat dhe **konceptet sociale**.
- **Simptoma josociale** – p.sh. interesa të kufizuara, sjellje ose qëndrim 'repetitiv' (përsëritje e veprimeve të njëjta), perceptim të fokusuar në detaje, ndjeshmëri të tepruar.

Për caktimin e diagnozës 'autizëm' duhet të gjenden anomali, përkatësisht simptoma, në

të dy fushat. Spikatja e simptomave mund të ndryshojë te secili person me autizëm. Në vazhdimësi kohore ato edhe mund të ndryshojnë.

Psikiatri për fëmijë Leo Kanner i ka përshkruar fëmijët, te të cilët simptomat autiste ishin të qarta që në moshën e foshnjërisë dhe të fëmijërisë së hershme. Shpeshherë, këta fëmijë nuk interesohen për personat rreth tyre. Nuk kërkojnë kontakt me sy me ta, nuk e rikthjenë buzëqeshjen, reagojnë vetëm pak ose hiç fare ndaj zërit të prindërve dhe nuk ofrojnë përqafile e puthje siç bëjnë zakonisht fëmijët e tjerë. Nuk provojnë t'ua tërheqin vëmendjen prindërve tek vetja ose tek objektet interesante. Nuk flasin fare ose vetëm në mënyrë shumë të thjeshtë. Shpeshherë merren me të njëjtat objekte, p.sh. duke rrotulluar gjithmonë rrotat e një veture lodër ose duke renditur objekte në një varg. Kur janë shumë të shqetësuar ose të emocionuar i lëvizin duart ose gjithë trupin në mënyrë jo të zakonshme. Kur dëgjojnë zhurma ose tinguj të veçantë reagojnë shpeshherë në mënyrë tejet sensible. Jo rrallë janë të

prekur nga ngeçjet/vonesat në zhvillimin e tyre të përgjithshëm. Kjo formë e autizmit diagnostikohet si «autizëm i fëmijërisë së hershme».

Me rëndësi të madhe:

Problemet e përshkruara këtu mund të shfaqen në jetën e përditshme të njerëzve me autizëm në forma krejt të ndryshme dhe me pasoja të ndryshme. Megjithatë, askush prej të prekurve me autizëm nuk i ka të gjitha problemet e përmendura më lartë. Vështirësitë tejet të theksuara vërehen që në moshë të re. Te fëmijët me autizëm, diagnoza nganjëherë mund të bëhet që në moshën 2 – 3 vjeçare. Nëse simptomat nuk janë të theksuara fort, ato shpesh u bien në sy të afërmve ose vetë personave me autizëm me vonesë. Në këto raste diagnoza caktohet tek në moshën e adoleshencës ose në atë madhore. Kjo ndodh më shpesh te vajzat dhe gratë sesa te djemtë dhe burrat.

Në Vjenë i kanë rënë në sy pediatri Hans Asperger edhe fëmijë të tjerë. Ata ishin më të mëdhenj, kishin një gjuhë dhe inteligjencë të zhvilluar, mirëpo kishin probleme me empatinë, d.m.th. me vënie e vetes në gjendjen e dikujt tjetër, ose për të luajtur apo mësuar në grup me fëmijë të tjerë. Këta fëmijë shfaqnin shpesh interesa të theksuara, p.sh. për të dhënat në shifra ose për oraret e trenave; po ashtu ata edhe posedonin njohuri të mëdha në fushat e tyre specifike. Kjo formë e autizmit diagnostikohet sot me emrin «Sindromi i Asperger-it» (giermanisht: Asperger-Syndrom).

Për fëmijët me autizëm që nuk i takojnë njërës prej këtyre dy grupeve caktohet diagnoza «autizëm atipik».

Deri rreth vitit 1980 diagnoza e një çrregullimi autik është përdorur vetëm për fëmijë të tipit «autizmi i fëmijërisë së hershme». Kurse sipas konceptit të ri të spektrit të çrregullimeve të autizmit përfshihen edhe fëmijët me sindromin e Asperger-it edhe ata me autizëm atipik. Kjo është edhe arsyeja që diagnoza «autizëm», e cila më herët ishte mjaft e rrallë,

sot caktohet shumë më shpesh. Nga hulumtimet e reja rezultojnë që përafërsisht 1% e të gjithë njerëzve janë prekur nga autizmi. Disa prej studimeve nga SHBA nxjerrin në pah përqindje dukshëm më të lartë.

Cilat janë karakteristikat e simptomave të autizmit?

Ka modele të ndryshme përmes të cilave mund të shpjegohen aspektet sociale dhe josociale të autizmit.

Njohuri me vlerë të përgjithshme:

Shkaqet e spektrit të çrregullimeve të autizmit nuk janë të sqaruara deri sot plotësisht. Megjithatë është e sigurt që për krijimin dhe shfaqjen e tyre luajnë rol një varg faktorësh. Ndikimet gjenetike ose të mjedisit mund ta influencojnë zhvillimin e trurit para, gjatë dhe pas lindjes dhe mund ta shkaktojnë autizmin. Me siguri mund të thuhet që spektri i çrregullimeve të autizmit nuk shkaktohet nga gabimet në edukim ose nga konfliktet familjare.

Fusha sociale

Bebet neuortipike janë të fokusuar në masë të konsiderueshme te prindërit dhe te persona të tjerë që kujdesen për ta. Ato reagojnë ndaj shikimeve, zërit dhe prekjeve. Bebet me autizëm e shfaqin këtë motivacion social në masë shumë më të vogël. Duket se kontakti ndërnjerëzor i gëzon më pak. Nganjëherë duket se atë edhe e injorojnë. Kështu, ato krijojnë shumë pak përvoja sociale dhe që herët mbeten prapa sa i përket zhvillimit të tyre.

Që në moshë shumë të re, fëmijët janë në gjendje të perceptojnë emocione të persona-ve të tjerë dhe ta përshtasin sjelljen e tyre në mënyrën e duhur. Ata e ndjejnë, për shembull, kur prindërit e tyre kanë frikë në një situatë të caktuar ose kur zemërohen. Duke u rritur, ata po ashtu janë në gjendje të tregojnë empati, të vënë veten në pozicionin e një tjetri dhe ta kuptojnë perspektivën e tjetrit. Këto aftësi janë me rëndësi të madhe për çdo lloj komunikimi dhe ndërveprimi. Njerëzit me autizëm kanë probleme me këtë. Ata e interpretojnë shpeshherë sjelljen ose qëllimet e dikujt tjetër në mënyrë të gabuar, dhe kjo mund të

rezultojë me keqkuptime ose mosmarrëveshje.

Fusha josociale

Pak a shumë, të gjithë njerëzit me autizëm, sidomos në moshën e fëmijërisë, janë tepër të ndjeshëm ndaj zhurmimeve specifike, si për shembull ndaj zhurmimeve specifike, si për shembull ndaj: këmbanave të kishës, thithëses së pluhurit, britmave të fëmijëve, krismave, përzjerjeve të zërave ose zhurmave të tjera.

Disa njerëz me autizëm kanë probleme me dritë verbuese ose me kundërmime të caktuara (p. sh. të gjellëve apo të parfumit). Të tjerë janë shumë të ndjeshëm ndaj prekjeve. Ata nuk mund, për shembull, të prekin sende të rrëshqitshme ose ngjitëse. Nuk e durojnë konsistencën apo përbërjen e gjellërave të caktuara, ndihen të ngacmuar prej pantallonave të ngushta ose prej etiketave të rrobave.

Megjithatë del në pah që shumë njerëz me autizëm kërkojnë ngacmime sensuale për t'u çlodhur, për t'u qetësuar ose për t'u shpërqendruar dhe për ta stimuluar veten në momente të mërzitshme. Sidomos fëmijët kanë qejf, për shembull, të vështrojnë objekte rrotulluese ose vezulluese. Të tjerët vëzhgojnë

sipërfaqen e disa objekteve dhe trokasin mbi ta.

Studiuesi Leo Kanner ka përmendur në artikullin e tij që fëmijët me autizëm kanë frikë prej ndodhive të reja, prandaj preferojnë që çdo gjë të mbetet e pandryshuar. Frika prej



ndodhive të paparashikuara apo prej ndryshimeve të programit është e njohur edhe te të rriturit me autizëm. Ata i regjistrojnë ecuritë e proceseve të zhvilluara dhe synojnë që të njëjtat procese t'i zhvillojnë përherë në mënyrë të njëjtë. Në këtë mënyrë ata provojnë që në jetën e përditshme të mbrohen prej të papriturave, prej kërkesave të reja dhe prej stresit.

Njerëzit neurotipik janë në gjendje të orientohen në situata të reja dhe të kenë shpejt një mbivështrim mbi to. Kjo ua mundëson atyre që të adaptohen shumë shpejt me kërkesat e reja. Njerëzit me autizëm i regjistrojnë në fillim detajet e ndryshme, mirëpo nuk i vërejnë ndërlidhjet mes tyre, dhe si pasojë, nuk dinë si duhet të sillen. Ky perceptim i fokusuar mbi detaje mund të shihet nga ana tjetër edhe si një avantazh, sepse këta njerëz në rrethana të caktuara mund të shohin detaje, të cilat të tjerëve nuk u bien në sy. Kështu ata janë të gjendje të kryejnë detyra të caktuara në mënyrë posaçërisht të vëmendshme. Shpeshherë, këta njerëz kanë edhe një kujtesë jashtëzakonisht të mirë për detaje.

Njerëzit me spektër të autizmit orientohen shpesh në rregulla ose struktura. Mendimi i tyre është shpesh «bardh e zi». Sendet, veprimtaria dhe proceset janë ose krejt të drejta ose krejt të gabuara. Njerëzit me autizëm e kanë të vështirë të bëjnë kompromise.

Këto veçanti josociale quhen edhe «perceptim autist» ose «të menduarit në mënyrë autiste».

Termi «Spektri i çrregullimeve të autizmit»

Hulumtime të shumta tregojnë që ekspertët janë zakonisht të një mendimi kur është fjala për diagnostikimin me «autizëm», kurse kanë mendime të ndryshme kur është fjala për caktimin e nën-diagnozës (p.sh. autizëm i fëmijërisë së hershme, autizëm atipik, sindromi i Asperger-it). Specialistët amerikanë kanë vendosur që pikërisht për këtë arsye ta përdorin për autizmin në sistemin diagnostik të tyre DSM 5 vetëm termin «spektri i çrregullimeve të autizmit» (gjermanisht «Autismus-Spektrum-Störung», shkurt ASS). Për një përshkrim më të detajuar të personave me autizëm duhet shënuar a është fjala për një ASS, me ose pa pengesa në të folurit ose me dhe pa pengesa intelektuale, si p.sh. epilepsia. Shkalla sesa i theksuar është autizmi caktohet në bazë të nevojës për mbështetje të personit me autizëm (shkalla e ulët, e mesme, e lartë).

Sistemi i klasifikimit ICD-10, i përdorur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) si dhe në Zvicër, është zëvendësuar prej 1 janarit 2022 me sistemin ICD-11.

Edhe në këtë klasifikim figuron vetëm diagnoza kryesore «Spektri i çrregullimeve të autizmit». Kjo diagnozë specifikohet më tej si autizëm (ASS) me ose pa dëmtim të zhvillimit intelektual dhe/ose gjuhësor. Gjatë një periudhe kalimtare përdoren po ashtu diagnozat e njohura (autizëm i fëmijërisë së hershme, autizëm atipik, sindromi i Asperger-it).



Ana tjetër e autizmit

Edhe pse deri tash u tematizuan kryesisht vështirësitë dhe problemet, me të cilat njerëzit me autizëm ballafaqohen në jetën e tyre të përditshme, ata i kanë edhe anët e tyre të forta. Njerëzit me spektër të autizmit janë në përgjithësi të sinqertë e të hapur dhe të drejtë në komunikimin e tyre. Ata nuk njohin paramendime me prapavijë dhe gënjeshtër. Nëse ata interesohen për një temë ose një veprimtari, mund të thellohen në të me entuziazëm dhe këmbëngulje dhe mund të fitojnë njohuri dhe aftësi të shumta. Veprimtaritë përkatëse i realizojnë në mënyrë të përgjegjshme e të përqëndruar. Njerëzit me autizëm janë posaçërisht të përshtatshëm për shumë punë që kërkojnë saktësi dhe kuptim të detajeve.

Natyrisht se shansat e tyre për një zhvillim profesional të suksesshëm rriten dukshëm, në qoftë se qëllimshëm arrihet që interesi i veçantë të njeriut me autizëm të lidhet me një formim profesional dhe me një profesion përkatëse.



**Ta njohim spektrin
e çrregullimeve të
autizmit**

Diagnoza

Në të shumtën e rasteve janë prindërit ata që kanë halle lidhur me zhvillimin e fëmijës së tyre, ose që kanë përshtypjen se «diçka nuk është në rregull». Mirëpo ka edhe raste kur të parët që shprehin dyshimin janë ekspertët, të cilët e shohin fëmijën në një grup. Nganjëherë, për shkak informatave ose pyetësorëve përkatës në internet, janë edhe vetë të rinjtë/të rejat, ose të rritur që dyshojnë se ndoshta kanë çrregullime të autizmit (çrregullime autike), p.sh. pasi kanë marrë informata ose janë shërbyer me pyetësorë përkatës në internet. Në rastet kur një fëmijë analizohet, sepse dyshohet që ai është me autizëm, mund të ndodh që edhe babai ose nëna të zbulojnë mënyra sjelljeje të ngjashme edhe te vetëvetja.

Perveç testimeve të standardizuara, diagnoza e çrregullimit të autizmit bëhet edhe

në bazë të vëzhgimit intensiv të situatave në jetën e përditshme. Te fëmijët pyeten zakonisht së pari prindërit ose ekspertët, të cilët e njohin fëmijën nga shkolla, çerdhja ose nga terapitë. Edhe në raste të personave të rritur me autizëm rekomandohet që sipas mundësive të pyeten prindërit e tyre. Vetëkuptohet që personi me autizëm duhet të japë informata sa më të detajuara për jetën e tij aktuale dhe atë në të kaluarën. Në anketim mund të përfshihen edhe miqtë/mikeshat të afërt ose partnerët. Kur është fjala për fëmijë, hulumtimi mund të bëhet edhe duke e vëzhguar fëmijën në mënyrë të strukturuar, se si sillet ai kur është duke luajtur. Një ndihmë mund të jetë vëzhgimi i fëmijës kur ai gjendet në një grup. Përveç deklarimeve përmbajtësore analizohen te të rinjtë/të rejat dhe te të rriturit edhe aspektet e komunikimit joverbal,





◀ *Edhe në qoftë se diagnoza bëhet vetëm mbi bazë të një dyshimi nuk duhet të humbet tepër kohë, por duhet të fillohet sa më parë me masat përkrahëse.*

ato të reciprocitetit në biseda dhe të të kuptuarit social. Ekspertët e autizmit duhet të kenë kryer studime specifike që të mundën të bëjnë analiza të besueshme, duke i përsëritur ato në intervale të caktuara kohore. Diagnoza te fëmijët me autizëm të fëmijërisë së hershme mund të bëhet zakonisht në moshën 2- deri 2 ½-vjeçare. Problemet te fëmijët me sindromin e Asperger-it shfaqen në të shumtën e rasteve në mënyrë të qartë vetëm në moshën parashkollore dhe në atë shkollore. Simptomat autiste mbulohen nganjëherë nga depresionet, fobitë ose shtrëngimet psikike, duke e vështirësuar kështu diagnostikimin e tyre.

Diagnoza korrekte është parakusht për një përkrahje dhe inkurajim specifik lidhur me autizmin, sepse në përputhje me diagnozën e caktuar mund t'u ndihmohet të rinjve/të rejave dhe të rriturve që t'i kuptojnë më mirë problemet e tyre në jetën e përditshme dhe të kërkojnë rrugë të reja. Prindërit, miqtë dhe partnerët, mësimdhënësit dhe punëdhënësit mund të gjejnë informata në lidhje me autizmin dhe mund t'i kuptojnë kështu më mirë njerëzit me autizëm.

Spektri i çrregullimeve të autizmit shfaqet në forma shumë të ndryshme

Ndonëse njerëzit me autizëm kanë disa karakteristika të përbashkëta, spektri i çrregullimeve të autizmit shfaqet në forma shumë të ndryshme.

Çdo njeri (qoftë fëmijë, i ri/e re ose i/e rritur) dallon nga të tjerët. Siç e tregojnë shembujt vijues edhe simptomat mund të shfaqen në forma krejt të ndryshme.

Komunikimi dhe të folurit

Timo nuk flet dot fare. Klara tregon pa ndërprerje për temën e saj të preferuar dhe nuk e kupton që në atë mënyrë i mërzit të pranishmit. Tina i përsërit si një jehonë fjalët të cilat personi përballë saj sapo i ka thënë. Erik-u bisedon me dëshirë për tema, për të cilat ai ka shumë njohuri – ai duket si njeri i dijshtëm dhe gjykohet nga të tjerët si mësimdhënës. Simonës i duhet përherë një kohë e gjatë deri sa t'i përgjigjet një pyetjeje.

Ndërveprim social

Majk-u dëshiron ta luaj gjithmonë të njëjtën lojë; ai nuk është gati t'i respekto-

jë dëshirat e fëmijëve të tjerë. Selina nuk është në gjendje të kuptojë nga zëri ose mimika e nënës, a është ajo e zemëruar ose e rraskapitur. Sandro nuk i kupton rregullat e lojërave në grup dhe nuk mund të marrë pjesë në to në mënyrë aktive. Maria nuk di si t'i drejtohet dikujt ose ta fillojë një bisedë.

Vënie kontakti


Mia e ka të vështirë ta shikojë dikë drejt në sy – ajo preferon që të tjerët t'i vëzhgojë me bisht të syrit. Jonas-i nuk ka droje ose ngurtime, ai shtron pyetje pa takt, u afrohet të panjohurve dhe nuk e kupton se nuk duhet



t'i prekë. Sonja nuk di se si të vendosë lidhje me dikë. Bisedat e lehta janë për të të pamundura.

Ndjeshmëri e tepruar

Sarah është shumë e ndjeshme ndaj zhurmave – tingulli i një thithëse të pluhurit e vë në panik. Disa kundërmime janë për Leonin të padurueshme. Petrit i vjen zor të shkojë të blejë në dyqane. Në supermarket ka tepër njerëz dhe drita është tepër verbuese. Prek-



«Një bisedë e zakonshme mund të tingëllojë nganjëherë sikur po ndiqen njëkohësisht disa emisione televizive.»

Temple Grandin

jet e papritura janë për Petrin të bezdisshme dhe stresuese.

Sjellja ndaj ndryshimeve

Për Zhoel-in ka rëndësi të madhe që ai në punë të jetë i ulur në të njëjtin vend. Ana ka probleme nëse bëhen ndërrime mes orëve të mësimit. Luis-i preferon ta hajë gjithmonë të njëjtën gjellë. Petri zgjedh përherë të njëjtën rrugë për të shkuar atje ku ai dëshiro. Kantierat ose devijimet në

rrugë e stresojnë dhe nidkojnë që ai të ndihet i pasigurt.

Interesa të theksuara

Feliks-i ka pak fantazi për të luajtur, andaj ai preferon t'i rrotullojë vazhdimisht rrotat e lodër-veturës së tij. Klaudio e kalon kohën e lirë gjithmonë në të njëjtin ritëm. Idris-i i adhuron enigmat (puzzle-të) e komplikuara dhe lojërat për ushtrimin e durimit. Luka interesohet për çdo gjë që ka të bëjë me trenat;

me këtë temë ai merret me orë të tëra. Dominik-u është në gjendje të jetë një nxënës i shkëlqyeshëm, në qoftë se një lëndë lidhet me 'temën speciale' të tij. Tim-i preferon të rrijë për orë të tëra para kompjuterit, të luajë «games» ose të kërkojë informata për temën e tij të preferuar. Paul-i i njuh të gjitha tipet e orëve të vjetra. Paula ka një fascinacion për objekte rrotulluese. Ajo mund të rrijë për orë të tëra para lavatriçes duke e vëzhguar atë. Robert-i troket mbi të gjitha siperfaqet dhe bën shumë kujdes për tingujt..





**Sjellja me perso-
nat me spektër të
autizmit**

Ndihmat e mundshme dhe parimet e terapisë

«Si mund t'i ndihmojmë sa më mirë një personi me spektër të autizmit?» – kjo është çështja më e rëndësishme dhe njëkohësisht më e vështira për prindërit dhe për vetë personat me autizëm.

Zgjedhja e masave të përshtatshme për përkrahje varet gjithmonë nga moshja, nga shkalla e zhvillimit të fëmijës dhe nga spikatja e simptomave autiste. Për moshën parashkollore ekzistojnë forma të ndryshme preventive të intervenimeve të hershme. Në to kombinohen masa të ndryshme mjekësore (p.sh. terapia e sjelljes, ergoterapia) dhe pedagogjike (p.sh. përcjellja speciale pedagogjike për edukim të hershëm (gjermanisht: Heilpädagogische Früherziehung), logopedi). Masa të tjera preventive të hershme orientohen më shumë drejt terapisë me lojë. Pavarësisht dallimeve, të gjitha programet kanë një strukturë të qartë. Qëlli

limi i tyre është që të përkrahet zhvillimi i fëmijës në mënyrë sa më të gjerë.

Ndonëse përcjellja pedagogjike speciale duhet të jetë në plan të parë, vetëm një pjesë e familjeve të nevojshme mbështetet financiarisht, sepse financimi i programeve të tilla në Zvicër deri tani nuk është i siguar. Kjo do të thotë se vetëm një pjesë e familjeve të nevojshme merr përkrahje financiare. Prandaj te shumë fëmijë ofrohet së pari edukimi i hershëm special pedagogjik, pastaj sipas moshës, logopedia, ergoterapia, terapia psikomotorikë apo psikoterapia.

Fëmijë pak më të mëdhenj, të rinjtë/të rejtat dhe të rriturit dëshirojnë që në radhë të parë t'i përmirësojnë kompetencat e tyre sociale. Qëllimi i tyre është që të kuptojnë më mirë si mendojnë dhe si ndihen njerëzit në mjedisin e tyre, dhe mund të orientohen më mirë në grupe. Përveç kësaj, ata mund

të mësojnë si të gjejnë strategji për t'u përballuar me situata të vështira në jetën e përditshme. Shumë prej këtyre qëllimeve mund të arrihen më së miri në grupe. Personat me autizëm mësojnë në grupe që ata nuk janë vetëm me problemet e tyre.



Mirëpo, qëllimi i punës dhe mbështetjes nuk është që vetëm fëmijët, të rinjtë/të rejat dhe të rriturit me autizëm t'u përshaten mjedisit të tyre. Qëllimi është që njerëzit rreth tyre të informohen e të dinë çka është autizmi, sepse vetëm kështu mund të krijojnë një mjedis të përshtatshëm për autistët, qoftë në shtëpi, në shkollë ose në vendin e punës. Duke vepruar kështu, njerëzit me autizëm mund t'i shfrytëzojnë forcat dhe resurset e tyre dhe të dëmtohen më pak nga çrregullimet e tyre.

Fëmijët, të rinjtë/të rejat dhe të rriturit kanë të drejtën që gjatë shkollimit dhe formimit të mëtejshëm të kërkojnë që shkollimi ose formimi i mëtejshëm t'u përshtatet nevojave të personave me autizëm në kuptimin e barazisë (gjermanisht: Nachteilsausgleich). Gjatë formimit profesional ose në vendin e punës, institucioni 'IV' (Invalidenversicherung, sigurimi invalidor) ofron masa për integrimin profesional dhe për përkrahje, p.sh. përmes trajnerëve, të cilët e përkrahin personin me autizëm dhe punëdhënësin e tij.



«Jeta me autizëm është një përgatitje mjerane për të jetuar në një botë pa autizëm. Mirësjellja ka krijuar rrezeqë rrëshqitëjeje si në vaj (gjermanisht: Fettnäpfe). Autistët janë mjeshtër të mosevitimit të tyre duke rrëshqitur vazhdimisht.»

Axel Brauns

Për fëmijët e prekur nga autizmi duhet të përgatiten e të instalohen masa të përkrahjes e të mbështetjes që përputhen me nevojat individuale të tyre. Prej programeve me qëllime përkatëse përfitojnë jo vetëm fëmijët me autizëm, por edhe të rinjtë/të rejat dhe të rriturit p.sh. duke ndjekur trajnime të sjelljes sociale ose të ergoterapisë.

Shoqata «autismus deutsche schweiz» ndihmon, këshillon dhe ndërmjetëson për të gjitha pyetjet rreth autizmit.

Çka mund të bëjnë të afërmit ose mjedisi?

- Ata mund të kërkojnë këshilla dhe përkrahje tek ekspertët
 - Ata mund të kontaktojnë familje të tjera me një person me autizëm
 - Ata mund të njihen me anët e forta të personit me autizëm dhe mund t'i vlerësojnë dhe përkrahin forcat në fjalë
 - Ata mund të kërkojnë terapi, trajnime sociale dhe masa përkrahëse përkatëse për personat me autizëm
 - Ata mund të krijojnë «zona të qeta», ku mund të tërhiqet d.m.th. të jetë i qetë personi me autizëm
 - Ata mund të tregojnë durim kur personit me autizëm i nevojitet më shumë kohë për t'u shprehur
 - Ata mund të provojnë t'i kuptojnë mendimet dhe reagimet nganjëherë pak të çuditshme të personit me autizëm dhe të tregojnë empati ndaj tij
 - Ata mund t'i motivojnë të prekurit nga autizmi që t'u bashkangjiten e të bashkëveprojnë në aktivitetet e tyre, edhe nëse ata vetë do të preferonin të rrinë në shtëpi
 - Ata mund të planifikojnë e t'i sqarojnë në mënyrë të kujdesshme ndryshimet dhe kalimet nga një aktivitet te tjetri, duke patur kujdes që ndryshimet dhe kalimet të bëhen hap pas hapi
 - Ata mund të zgjedhin një shkollë dhe më pas edhe një vend formimi ku personi me autizëm përkrahet mirë
 - Ata mund të kujdesen që njerëzit rreth personit me autizëm (kujdestarët mësimdhënësit, ekspertët, autoritetet dhe të tjerë) të jenë të informuar sa më mirë dhe të bashkëpunojnë
 - Ata mund të kërkojnë këshillime nga këshilltarët për zgjedhjen e profesionit (gjerm.: Berufsberatung), të cilët posedojnë njohuri për autizmin
 - Ata mund të kontribuojnë në gjetjen e një vendi të përshtatshëm pune sipas interesave dhe aftësive të personit me autizëm
 - Ata mund të kërkojnë në vendin e punës të personit me autizëm dikë i cili i njih veçantitë e personit me autizëm dhe i cili e përkrah atë kur paraqiten vështirësi
 - Ata mund të ndihmojnë në gjetjen e një forme të të banuarit, ku personi me autizëm mund ta ruajë pavarësinë e tij dhe ku i ofrohet përkrahje nëse duhet
 - Ata mund të ndihmojnë në gjetjen e hobive, përmes të cilëve personi me autizëm mund ta kalojë kohën e lirë dhe të cilët e vënë në kontakt me njerëz të tjerë
- Ata mund të jenë të kujdesshëm ndaj nevojave të personave me autizëm dhe mund të kujdesen për një mjedis të përshtatshëm për autistët**



Si njeri i prekur nga autizmi më nevojitet ...

10 dëshira të njerëzve me çrregullime të spektrit të autizmit

Të më shihni në radhë të parë si njeri dhe jo si person me autizëm

Autizmi vërtet është një pjesë e qenies sime, mirëpo ai nuk është gjithçkaja ime. Nëse ndjej që nuk keni besim në aftësitë e mia, atëherë as nuk mund të provoj ta përballoj sfidën në fjalë.

Bëni një dallim mes «unë nuk dëshiroj» dhe «unë nuk mundem»

Puna nuk është që unë nuk dëshiroj t'i respektoj udhëzimet – unë thjesht nganjëherë nuk i kuptoj. Ejani te unë dhe më thoni në mënyrë të qartë se çka dëshironi. Vetëm kështu mund t'u kuptoj.

Mos flisni me mua në mënyrë të shumëkuptimshme

Unë e marr çdo gjë fjalë për fjalë. Fjalët e urta, lojërat me fjalë, aludimet ose ironitë nuk i kuptoj.

Dëgjomëni, unë provoj të komunikoj

Për mua është shumë e vështirë të them çka më nevojitet, kur nuk di si t'i përshkruaj ndjenjat e mia. Mund të kem uri, të jem i trishtuar ose të kem frikë, mirëpo s'di t'i gjej fjalët përkatëse. Bëni kujdes për gjuhën time të trupit – shenjat tregojnë si jam, ngase ato janë shpeshherë të dukshme. Provoni t'i njihni e t'i kuptoni.

Përdorni vizatime dhe skica, tregomëni shembuj – unë jam njeri vizual

Tregomëni në mënyrë konkrete si duhet të bëj diçka, mos bëni përshkrime vetëm me fjalë. Përkrahja vizuale, me të parë, më ndihmon më shumë sesa fjalët.



Përqendrohuni në atë që jam në gjendje ta bëj – dhe jo në atë që nuk mund ta bëj

Kurajo për të mësuar diçka të re më shuhet, nëse vazhdimisht e kam ndjenjën që nuk jam mjaft i mirë. Kërkoni anët e mia të forta dhe mos harroni: ekziston më shumë se një rrugë për të arritur diçka.

Ndihmomëni në ndërveprimet sociale

Shpjegomëni si mund të luaj me fëmijë të tjerë ose si duhet ta filloj një bisedë si i ri/e re ose i/e rritur. Inkurajomëni që të vë kontakt me të tjerët.

Kini durim

Më jepni kohë për t'i përpunuar informatat që të reagoj ndaj tyre. Ndani kërkesat tuaja në hapa të vegjël që të jem i suksesshëm.

Zbuloni çka më shkakton të nxehem (të shpërthej)

Mund të rrënohem dhe mund të reagoj në mënyrë të fuqishme, nëse ngarkimet janë

tepër të mëdha për mua. Zbuloni bashkë me mua cilat janë arsyejet dhe si mund t'i evitojmë situatat e tilla në të ardhmen. Shpeshherë kur unë nuk kuptoj diçka saktësisht frikësohem. Meqë nuk di të shprehem në mënyrë adekuate mund të reagoj në mënyrë impulsive. Edhe dhimbjet, zhurmat e caktuara ose kundërmimet dhe prekjet mund të ndikojnë që të shpërthej furishëm.

Pranomëni dhe më doni kështu si jam

Mos harroni që nuk e kam zgjedhur fatin të jem një person me spektër të çrregullimeve të autizmit. Kështu më ka ndodhur mua, dhe jo juve. Perspektivat për një jetë të suksesshme zvogëlohen, në qoftë se nuk e kam përkrahjen tuaj. Shansat e mia për një jetë të pavarur e të suksesshme mund të jenë shumë më të mëdha sesa mund t'i parrafytyroni, në qoftë se më ofroni përkrahje.

(Burimi: Ellen Notbohm, 10 things a child with autism wishes you knew, 2012)



Ta kuptosh autizmin, të jetosh me autizëm




Në Zvicër jetojnë afërsisht 80'000 njerëz me spektër çrregullimesh të autizmit. Vetëdijesimi ndaj kësaj teme ka ndryshuar shumë në njëzet vitet e kaluara. Këshilli Federal i ka dokumentuar në një raport dëshirat dhe kërkesat e rëndësishme të personave me autizëm dhe të të afërmeve të tyre. Mbetet që përmirësimet e formuluar në këtë raport të realizohen sa më mirë.


«Prindërit janë ende të detyruar që ta kërkojnë rrugën e vetë. Ka tepër mangësi sa i përket përkrahjes dhe përcjelljes të njerëzve me autizëm.»

Shoqata «autismus deutsche schweiz» i bashkon prindërit, njerëzit me autizëm dhe ekspertët me qëllim që të gjithë ata të mund të sillen më mirë me autizmin. Bëhuni anëtar/e edhe ju!

autismus deutsche schweiz

Reto Odermatt, Präsident





Njerëzit me autizëm kanë nevojë për përkrahje dhe angazhim.

Njerëzit me autizëm kanë nevojë për përkrahje dhe angazhim.

E themeluar si shoqatë e prindërve, «autismus deutsche schweiz» është sot organizata zyrtare për autizëm dhe është e njohur nga zyra federale për sigurimin social (Bundesamt für Sozialversicherungen). Shoqata «autismus deutsche schweiz» është një rrjet për prindërit, të afërmit, personat me autizëm dhe ekspertët. Shoqata në fjalë ofron ndihmë dhe këshillim të shpejtë dhe joburokratik. Ajo organizon konferenca dhe punëtori (Workshops), mbledhje informative dhe ngjarje kompatible me autizmin. Përveç kësaj, shoqata «autismus deutsche schweiz» angazhohet në politikë dhe në shoqëri me qëllim që njerëzit me spektër çrregullimesh të autizmit të kuptohen e të përkrahen më së miri.

Duke u bërë anëtar/e ose duke e përkrahur shoqaten «autismus deutsche schweiz» ju ua mundësoni njerëzve me autizëm një jetë pa stres dhe të pavarur

Numri i kontos për ndihmë: PC 80-52832-2

www.autismus.ch




Këshillim dhe përkrahje

Telefon: 044 341 13 13

Mail: anfrage@autismus.ch

autismus deutsche schweiz
Riedhofstrasse 354
CH-8049 Zürich

Spendenkonto PC 80-52832-2
 www.facebook.com/autismus.ch
www.autismus.ch

autismus **deutsche schweiz**
Verein für Angehörige, Betroffene und Fachleute

hilft,
vermittelt und
verbindet